



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sou.

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0042000-14/26 dt. 29.07.2026

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 13, paragrafi 1, pika 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 3 paragrafi 1, 2 dhe 5 i Rregullores Komunale Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.07.2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0041998-14/26 dt. 28.07.2026); sjell këtë:

VENDIM

Për mbështetje financiare (subvencionim) të 8 (tetë) Familjeve të prekura nga rrëshqitja e dheut në Lagjen Bair

1. MIRATOHET Vendimi për mbështetje financiare të 8 (tetë) Familjeve të prekura nga rrëshqitja e dheut në Lagjen Bair.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi 8 (tetë) Familje të prekura nga rrëshqitja e dheut në Lagjen Bair, mbështeten financiarisht në vlerë prej 250.00 (dyqindpesëdhjetë) € euro në muaj, për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të qirasë nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere – Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten në xhirollogarinë e Familjeve të prekura nga rrëshqitja e dheut në Lagjen Bair, të cilat jetojnë në kushte të rënda si pasojë e rrëshqitjes së dheut, rrëshqitje që ka rrezikuar sigurinë e pronave të tyre dhe ka pamundësuar jetesën në kushte normale, familje të cilat janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre dhe kanë siguruar strehim me qira.
4. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Enitet KAMBERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- DBF-së
- DMS-së